



353  
24.02.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË  
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 02, datë 27.01.2023

PËR  
AKREDITIMIN PERIODIK TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË  
UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”, KORÇË

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 17.09.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksonimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit”, dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 27.01.2023, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin periodik institucional të **institucionit të arsimit të lartë, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, me të dhënat si më poshtë:**

- a) Emërtimi i institucionit të arsimit të lartë: **Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë**
- b) Organizimi i institucionit: **Publik**
- c) Lloji i institucionit: **Universitet**
- d) Njësitë kryesore të institucionit:
  - a. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë
  - b. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
  - c. Fakulteti i Ekonomisë
  - d. Fakulteti i Bujqësisë
- e) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 5, datë 07.01.1992
- f) Akti zyrtar i riorganizimit: Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 213, datë 24.05.1994
- g) Akreditimi i parë: Vendim i Bordit të Akreditimit Nr. 65, datë 21.09.2017

## pasi **mori në shqyrtim:**

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e përgjithshme institucionale, Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- b. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- c. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, i përbërë nga ekspertë të huaj dhe vendas;
- d. Raportimin e Ekspertëve të Vlerësimit në mbledhjen e Bordit;
- e. Rezultatet e Vlerësimit të Jashtëm Institucional;
- f. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- g. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;
- h. Raportin e Vlerësimit të Jashtëm dhe rezultatet e akreditimit të parë të këtij institucioni të Arsimit të Lartë;

## **konstaton se:**

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore, procedurën dhe afatet e përcaktuara nga ASCAL për këtë proces;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimin e Jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Institucioni ka përmbushur rekomandimet e lëna nga akreditimi i parë;
- e. Rezultatet e vlerësimit të akreditimit periodik janë nxjerrë në përputhje me gjetjet: pikat e forta, pikat e dobëta dhe afirmimet e identifikuar e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- f. Rekomandimet e lëna janë në koherencë me gjetjet si dhe shkallën e përmbushjes së standardeve të cilësisë për institucionin në fjalë;
- g. Rezultatet e Vlerësimit të Jashtëm në lidhje me shkallën e plotësisë të Standardeve Shtetërore të Cilësisë për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, sipas fushave janë: Fusha 1 “**përmbushen plotësisht**”, Fusha 2 “**përmbushen plotësisht**”, Fusha 3 “**përmbushen plotësisht**”, Fusha 4 “**përmbushen kryesisht**”, Fusha 5 “**përmbushen plotësisht**”.
- h. Vlerësimi përfundimtar i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për cilësinë akademike për këtë institucion është pozitiv, me mangësitë si më poshtë:
  1. Mungesa e një buxheti dhe mbështetjeje financiare të strukturuar për personelin akademik, në kuadër të projekteve kërkimore shkencore dhe pjesëmarrjes në konferenca, kongrese etj, e cila ka bërë që aktiviteti kërkimor shkencor i personelit akademik, veçanërisht publikimet në revista me faktor impakti, të jetë i ulët.
  2. Mobiliteti i personelit akademik dhe studentëve, është i ulët.
  3. Mungesa e mekanizmave të institucionalizuara të komunikimit, midis Universitetit dhe grupeve të interesit apo partnerëve me të cilët bashkëpunon.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,


### VENDOSI:

1. **Vlerësimin përfundimtar POZITIV** për institucionin e arsimit të lartë, **Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë**, me rekomandimet sipas shtojcës së këtij vendimi.
2. **Akreditimin institucional** të institucionit të arsimit të lartë, **Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë**, me kohëzgjatjen prej **4 (katër) vite**.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të institucionit është **26/01/2027**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ



Kryetare

ALEXANDER KOHLER




Anëtar

AYŞEN SAVAŞ SARGIN



Anëtar

TOMASZ JELENSKI



Anëtar

IRAJ HASHI




Anëtar

MAURICE OUDEJANS



Anëtar

LEA YPI




Anëtar

KITA SALLABANDA DIAZ



Anëtar

DARINKA PIQANI



Anëtar

DRITAN NAÇE



Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar

## Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 02, datë 27.01.2023, “Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë, **Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë**”, janë si vijon:

1. Institucioni, të rrisë mbështetjen për personelin akademik në mënyrë të strukturuar, duke përcaktuar një buxhet të dedikuar për aktivitetet kërkimore shkencore, me qëllim rritjen e aktivitetit kërkimor shkencor, pjesëmarrjen në konferenca si edhe publikimin në revista me faktor impakti.
2. Institucioni, të mbështesë e nxisë me tej mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve.
3. Institucioni, të krijojë mekanizma të strukturuar të komunikimit me grupet e interesit dhe partnerët me të cilët bashkëpunon.
4. Institucioni, të përditësojë faqen e tij zyrtare të internetit edhe me informacione që lidhen me punën kërkimore shkencore të personelit akademik.
5. Institucioni, të rrisë përpjekjet për zbatimin e strategjisë së rekrutimit të personelit akademik të kualifikuar dhe të zhvillojë një strategji efikase për rritjen e numrit të studentëve.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

